

ISMAIL EFENDI NDROQI NJË JETË NË SHËRBIM TË PAVARËSISË SË ATDHEUT DHE EDUKIMIT SHPIRTËROR TË BREZAVE

Datat 28 nëntor 1912 dhe 11 shkurt 1920 janë ndër datat më kulmore në historinë tonë kombëtare të këtyre 110 viteve të fundit. Patriotët, njerëzit e përparuar, të shkolluar e të aftë që u vunë në drejtim të Shqipërisë dhe të kryeqytetit, ishin vizionarë. Ata kishin studiuar dhe jetuar në vende të përparuara dhe dëshironin që edhe Shqipëria jonë të kishte fytyrën e një vendi të përparuar, të lirë e më vete.

Familja Ndroqi, që nga stërgjyshi ynë, Aliu, shquhej në Tiranë si familje bamirëse dhe derë nacionalistësh, me veprimtari patriotike, ku shquhen tre vëllezërit: Ibrahim, figurë e ndritur e shqiptarizms në Tiranën e asaj kohe që kishte titullin “Myderriz” (profesor), Ismaili dhe Mehmeti, vëllai i tretë, ishte patriot i shquar, pjesëmarrës në lëvizjet përparimtare në fillimshkullin XX, i cili ngriti shtypshkronjën “Gutenberg”, e para në Tiranë, që përhapte librin, dijen e kulturën.

Ismail Ndroqi është figura më e spikatur e familjes në këto periudha, shumë aktiv në jetën politike, qytetare e shpirtërore (fetare). Pas përfundimit të arsimit fillor në Tiranë, dërgohet në Stamboll ku kryen arsimin e mesëm dhe të lartë në Universitetin e Stambollit për Teologji dhe Filozofi, nga viti 1893, deri në vitin 1908. Gjatë këtyre viteve, ai u lidh dhe bashkëpunoi me patriotët shqiptarë në Stamboll, si me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Naim e Mehmet Frashërin, e të tjerë, të cilët u përpoqën të vinin në jetë vendimet historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kishte kontakte edhe me figura përparimtare të Turqisë dhe mori pjesë në një nga partitë më përparimtare të kohës, në opozitë me qeverinë reaksionare. Ai kishte rënë në sy dhe ishte shënuar për t’u mbajtur në mbikëqyrje nga autoritetet turke edhe në vendlindje.

* Ish - nënkryetar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, gusht 2020.

Kur u kthye në atdhe, në vitin 1908, dha mësim në Medresenë e Tiranës, por në 1909-n e largojnë nga medreseja, për arsye se ishte shqiptar i flaktë dhe me mendime përparimtare në interpretimet e mësimave fetare, mendime të cilat nuk përkonin me pikëpamjet obskurantiste. Ai vazhdoi të jepte mësim pranë Xhamisë së Vjetër, pastaj në medrese, në vitet 1909-1912, duke edukuar nxënësit e tij me dije të shëndosha dhe patriotizëm.

Në këto qendra arsimore ai u bë i dashur e i respektuar nga të gjithë. U shqua për veprimtari kombëtare dhe në lëmin e përhapjes në fshehtësi të gjuhës dhe kulturës amtare. Ndër nxënësit më të mirë, ishin edhe atdhetarët e vendlindjes së tij, si Beqir Tafani e Musa Vathi. Krahas metodës së bukur të shpjegimit, ai zhvillonte diskutime e polemika, ndërthurur me mendimet e filozofëve të kohës. Ai i mësonte nxënësit:

“Duhet të bindeni dhe ta provoni vetë atë që mësoni! Në qoftë se nuk jua pranon logjika, mos i pranoni e mos i besoni, si për shembull dogmave të kota!”

Në vitet 1908-1910 bëhet anëtar i klubit “Bashkimi”. Ismaili u shqua për veprimtari kombëtare në lëvizjet për pavarësi në Tiranë, në vitet 1908-1912, si dhe në përhapjen e gjuhës dhe kulturës amtare. Autoritetet xhonturke dhe kleri reaksionar e kërcënuan dhe e pushuan nga puna.

“Ismail Efendiu endej pa pushim nga një shtëpi në tjetrën, që, nëpërmjet fjalës dhe këshillave, të përgatiste tryezat e dashurisë kombëtare dhe të shtonte radhët e luftëtarëve për liri”.

“Ata ndër male ishin përбетue t’a hidhnin në altarin e Atdheut jetën, edhe ai ishte përбетue t’a vejë peng jetën për hir të kombit: ishte për çdo minut në rrezik që t’u kapte nga kundërshtarët e vet, për t’u çue ndër shkretëtirat “Jedi Kules” ose të “Garb Tarabulluzit”, ashtu si u ngjau edhe disa veteranëve të tjerë të këtij qyteti (gazeta “Bashkimi i Kombit”).

Ismaili u bë një nga figurat kryesore të lëvizjes kombëtare kundër pushtuesve osmanë dhe shovinistëve fqinjë, të cilët punonin për copëtimin e Shqipërisë. Ai u lidh dhe u organizua me patriotët të tjerë, si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Hoxhë Kadria dhe shumë të tjerë edhe në kohën e kryengritjeve të mëdha në Kosovë. Këta patriotë, zhvilluan një veprimtari të organizuar për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Mori pjesë aktive në veprimtaritë dhe Komisionin për Ngritjen e Flamurit Kombëtar në Tiranë, në 26 nëntor 1912, dhe për shpalljen e

Pavarësisë sonë kombëtare. Së bashku me patriotët si Refik e Fuat Toptani, sheh Ahmet Pazari, Xhemal Toptani, Abdullah Gjinali, haxhi Isuf Banka, Sulejman Kadiu, Shefik Kondi, Myslim Beshiri, Selim Petrela, Hysen Shehri, Nikolla Nishku e të tjerë firmëtarë në shpalljen e “Indipendencës” në emër të Shqipërisë, më 26 nëntor 1912, në emër të popullit të Tiranës, ai mori pjesë në ngritjen e flamurit në Tiranë.

Sipas “Dokumenta historike”, ata i dërguan një telegram:

“Përfaqësuesve të Shqipnis dhe Shkëlqesisë së Tij, Ismail Qemal Beut, Vlonë. Tashti shpallim Indipendencën në emër të Shqipnis. Kërkojmë e lutemi të ruhen të drejtat e pamohushme të Indipendencës tonë. Nga përfaqësuesit e të gjithë popullit të Tiranës”. Ndërsa nga komisioni njoftojnë telegrafisht: “Popullit të Lushnjës, Peqinit, Beratit, Gjirokastrës e të gjithë Shqipnisë.

Ju japim lajmin e gëzuem, se sot Tirana ngriti Flamurin Kombëtar e shpalli Indipendencen, në emën të të gjithë popullit shqiptar. Për me i premun hovin rrezikut të madh në të cilin ndodhemi, me të shpejtë shpallni Indipendencën edhe aty, edhe t'i drejtohemi konsujve të shteteve të mëdha në Durrës. Presim me padurim ta shpallni shpejt dhe të na epni lajmin e gëzuar tuajin. Përfaqësuesit e popullit”.

Ndër emrat që dërgojnë telegramin, është edhe emri i Ismail Ndroqit.

Para aktit të pavarësisë, patriotët tiranas ofruan ndihmë gjatë udhëtimit të Ismail Qemalit që zbriti në Durrës, për të vazhduar pastaj në një vend më të sigurtë, për në Vlorë, për shpalljen e pavarësisë. Disa prej tyre, si Abdi Toptani e të tjerë, e pritën në Durrës dhe e shoqëruan në rrugëtimin e rëndësishëm. Siç shihet, nga dokumentet e kohës dhe nga telegramet që dërgoheshin, veprimet e patriotëve shqiptarë në qytetet e qendrat kryesore ishin mjaft të koordinuara si për shpalljen e pavarësisë, edhe për organizimin e qeverive vendore dhe për mbajtjen e kuvendit mbarëkombëtar në Vlorë. Gjithashtu ishin të rëndësishme lidhjet me ambasadorët e huaj, konsujt e Austrisë, Francës, Italisë, dhe Korparmatën e Janinës, dhe dërgimi i promemorieve të qeverisë së re, drejtuar ushtrive serbo-malazeze, që kishin marrë Krujën dhe Qukësin, për të mos avancuar më tej në Tiranë, në tokat që nuk ishin më nën Turqinë, por ishin të një shteti të pavarur.

Në promemorien që dërgohej nga Vlorë, më 26 nëntor, për kryesinë e bashkive të Tiranës dhe Krujës, për t’ia dërguar komandave të ushtrive të huaja, shkruhej:

“Pasi Shqipëria me shpalljen e Indipendencës i ka premë krejt marrëdhëniet me Turqinë dhe dëshiron me u gjindë kurdoherë në relacione të mira e paqësore me shtetet fqinje asht e ditun se lufta që i kan shpallë Turqisë Serbia e Mali i Zi me mbretnitë e tjera nuk ka të bajë me Shqipërinë indipendente. Ju ftojme me hek dorë nga veprimet anmiqësore kundrejt Tiranës, Krusë, që asht një tokë e Shqipërisë indipendente”. Kjo ishte nënshkruar nga Abdi bej Toptani.

Ismail Ndroqi, së bashku me patriotët e tjerë tiranas, u bë bartës i zbatimit të vendimeve të Kuvendit të Vlorës dhe qeverisë së Ismail Qemalit dhe veproi kundër kundërshtarëve të saj. Kjo veprimtari patriotike për Shqipërinë dhe pavarësinë e saj, bëri që elementët obskurantistë të vepronin kundër tij. Atë e transferojnë si myfti në Shijak, në vitet 1913-1914, pastaj në Kavajë, në vitet 1914-1915. Edhe në këto vende, ai i shërbeu të mirës së atdheut dhe popullit, pasi ishte i përkushtuar për fe e atdhe. Në vitin 1914 shkoi me delegacionin europian për të qetësuar, nëpërmjet bindjes dhe bisedimeve, rebelizmin antikombëtar të Shqipërisë së Mesme, të udhëhequr nga Musa Qazimi e Haxhi Qamili, të cilët mbështesnin sundimin turkoshak kundër shqiptarizmit. Nëpërmjet bisedimeve dhe argumenteve filozofike dhe fetare, ai shpjegonte se:

“Me shkru e me nxanë shqipen, njeriu nuk bëhet kaur (i pa fe) dhe se feja e vërtetë nuk përjashton Fe e Atdhe”.

Në këtë kohë, si “shpërblim” për mbrojtjen e zjarrtë të idesë kombëtare dhe të aktivitetit patriotik, rebelët e persekutuan, e torturuan dhe e burgosën për 6 muaj. Atë e dënuan me vdekje, së bashku me disa atdhetarë të tjerë, por shpëtoi rastësisht nga ekzekutimi nga një grindje e grupit me njëri-tjetrin. I transferuan nga burgu i Shijakut në atë të Tiranës, në Kavajë, Peqin dhe më pas në burgun më të rëndë, në Elbasan.

Dijetari dhe patrioti Hafiz Ali Korça, bashkëvuajtës i tij në këtë periudhë, i përshkruan këto vuajtje në librat e tij dhe në fjalën e botuar, me rastin e vdekjes së Ismail Efendiut:

“Në kohën e Turqisë, u internuam, u burgosëm, u dënuam me vdekje. Ato nuk mjaftuan. Tani edhe prej vëllezërve tanë po rraskapitemi, torturohemi e do vritemi. Duke menduar dhe foshnjat në shtëpi, i thashë shokëve të bëjmë një lutje: “O Zot na shpëto ose jepi fund jetës sonë!”

I ndjeri u përgjigj:

“Ç’lutje është kjo? (nënkuptonte se t’i jepje fund jetës, nuk ishte fetare, as atdhetare). Edhe në atë moment të fundit tregoi burrëri e trimëri. Dhe vuajtja më e madhe e jona, ishin jo torturat dhe vdekja në prag, por dëgjimi i britmave rreth burgut: “Ngordhi shqipja, ngordhi shqipja””.

Në vitin 1916, Ismaili vjen përsëri si myfti në Tiranë, ku vazhdon veprimtarinë fetare me ide përparimtare dhe veprimtarinë politike me qëndrim të papajtueshëm me politikën antishqiptare të forcave përçarëse si dhe të fuqive të huaja pushtuese në vendin tonë. Në takimet me përfaqësuesit e pushtuesve austro-hungarezë ai ka mbajtur gjithnjë qëndrim dinjitoz, për të mësuar gjuhën amtare në shkolla. Kërkoj hapjen kudo në krahinat e Shqipërisë të shkollave tona. E shikonte zhvillimin e gjuhës amtare dhe të shkollave shqipe si një çështje kryesore. Predikonte që shkolla të bëhej shtëpia e dytë për çdo shqiptar. Me këtë rast, Ismaili përmendte vargjet e Hafiz Dalliut: *“Shkollë, o rrezja e Perëndisë, që ia ke çelë sytë gjithë njerëzisë!”*¹

Më 1917-1922, zgjidhet me votën popullore, si kryetar i Bashkisë së Tiranës, sepse populli shikonte tek ai një mëmëdhetar të shquar, të lidhur me problemet e qytetit, duke çmuar mençurinë, aftësitë e tij, ndershmërinë dhe karakterin e fortë, për të bërë punë të mira për qytetin.

Gjatë kësaj periudhe dhe deri në stabilitetin e shtetit shqiptar, veprimtaria e tij për çështjen kombëtare ka qenë e vazhdueshme dhe i bëri shërbime të mëdha atdheut.

Ka qenë organizator dhe delegat për përgatitjen e Kongresit të Tiranës, së bashku me patriotet të tjerë, si Abdi Toptani. Më 8 dhjetor 1918, njofton Elbasanin, që kongresi duhej për të siguruar bashkimin dhe njësimin e kombit shqiptar dhe për t’i prerë rrugën propagandave të huaja. Më 19-20 dhjetor 1918, u mbajt Kongresi i Tiranës, ku ai nënshkroi platformën e mbledhjes dhe kërkonte

“...të drejtat kombëtare dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet independent, me kufijtë natyralë dhe etnikë, me një apel që i drejtohej qeverive të Antantës, për të marrë nën kujdes të drejtat kombëtare dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve me kufijtë natyralë dhe etnikë”.

1 Revista “Dituria Islame”, 1991, Prishtinë.

Gjithashtu, më 25 dhjetor 1918, ka qenë delegat i Tiranës në Kongresin e Durrësit, me Abdi Toptanin dhe Shefik Kondin, ku u rreshtua përkrah elementeve përparimtarë që iu kundërvunë platformës proitaliane dhe doli haptas kundër qeverisë së këtij kongresi. Qëllimet e këtij krahu përparimtar, të përfaqësuar nga Luigj Gurakuqi, Lef Nosi, P. Mekshi, ishin për të siguruar triumfin e së drejtës së kombit dhe mbrojtjen e tij, si dhe për t'i dërguar mirënjohje qytetarit të madh amerikan, presidentit Uillson (Wilson), që shpalli të drejtat e kombeve mbi parimin e vetëvendosjes. Po kështu, t'i dërgohej mirënjohje senatorit Loxh (Lodge), i cili publikoi se një nga themelet mbi të cilin do të vendoset paqja e përgjithshme, do të jetë që edhe Shqipërisë, ndër shtetet e Ballkanit, t'i bashkohen të gjitha ato vise ku flitet gjuha shqipe dhe rron kombi shqiptar. U vendos që t'i dërgohej mirënjohje edhe shoqërisë “Vatra” në Amerikë dhe shoqërive të tjera shqiptare që përpiqeshin për të mirën e atdheut.

Sjelljet brutale të ushtrisë italiane, zbatimi i ligjit të pushtesit prej tyre dhe veprimet jo për interesa kombëtare të qeveritarëve të Durrësit u demaskuan nga patriotët shqiptarë, nga klubi “Dituria” i Tiranës dhe nga Ismail efendi Ndroqi. Në këtë kohë, ai ka qenë një nga organizatorët e Kongresit të Lushnjës. Në mesin e muajit prill 1919, edhe me porosi të klubit “Dituria”, u krijua një komision për të organizuar në Tiranë një kongres kombëtar për të shpëtuar vendin nga rreziku i copëtimit. Në krye të këtij komisioni u vu Ismail Ndroqi. Në vitin 1919, për realizimin e ideve dhe përgatitjen e kongresit (që u mbajt më pas në Lushnjë) mbledhja e parë dhe e ngushtë u bë në shtëpinë e tij. Bashkë me të ishin edhe atdhetarët e nderuar të trevës së Tiranës, Abdi Toptani, Myrtesim Këlliçi, Abdulla H. Mehmeti, Muhedin Llagami. Më e rëndësishme ishte mbledhja e dytë më e zgjeruar me më shumë se 20 vetë, ku morën pjesë një grup nga paria e qytetit dhe një grup nga të rinjtë, si Osman Myderrizi, Ali Begeja, Eshref Frashëri etj.

U zgjodh një komision nismëtar, nën kujdesin e Ismail Ndroqit, i cili filloi punën dhe marrëveshjet me të gjitha krahinat e Shqipërisë. Ata ishin në kontakt të veçantë me Abdyl Ypin, vrasja e të cilit në Durrës e shpejtoi kongresin. U acaruan shumë marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve italiane dhe veglave të tyre me popullin e Tiranës. Ata përqendruan forca të shumta ushtarake në Tiranë dhe vunë në veprim ligjin ushtarak, ndërsa Ismaili me patriotët e tjerë u qëndroi këtyre kërcënimeve ballë për ballë.

Për këto arsye, u organizuan mitingje proteste në Tiranë, gjatë muajve prill, korrik dhe gusht. Mitingu më i madh u bë më 28 nëntor 1919, ku krahas popullit dhe krerëve të tij, u shqua pjesëmarrja e Ismail Ndroqit,

kryetar i qeverisë vendore (bashkisë).

Së bashku me patriotë të tjerë tiranas, si Fuat dhe Abdi Toptani, Muhedin Llagami, Zyber Hallulli, Musa Vathi, Osman Myderizi etj., nënshkruajnë një promemorie, që populli i Tiranës ia dërgoi Konferencës së Paqes në Paris, më 1919, për moscopëtimin e Shqipërisë.

Zhvillimi i vrullshëm i ngjarjeve pas Luftës së Parë Botërore, bëri që fatet e atdheut të ishin në rrezik, ndaj kërkohej mençuri, guxim dhe sakrificë. Ismail efendi Ndroqi ishte bashkorganizator për përgatitjen (më 1919) dhe mbajtjen e Kongresit të Lushnjës, në janar të vitit 1920. Nga grupi organizator u vendos që kongresi të mbahej në Lushnjë, duke pasur parasysh rrethanat gjeopolitike dhe ushtarake.

Në letrën që Ismail Ndroqi i dërgon këtij kongresi, më 12 janar 1920, shkruhet:

“Në emër të popullit të Tiranës, të madh e të vogël, e përgëzojmë, solidarizohemi dhe premtojmë dërgimin e delegatëve në Kongresin e Lushnjës, por njëkohësisht, i lutemi organizatorëve të kongresit që këtë mbledhje të rëndësishme ta zhvillojmë në Tiranë dhe premtojmë se do të marrim të gjitha masat për zhvillimin normal të punimeve të Kongresit”.

Ai e vuri gjithçka në dispozicion të çështjes kombëtare dhe të zhvillimit të Tiranës. Siç shihet nga dokumentet historike, ndihmoi fuqimisht lëvizjen kombëtare të vitit 1920, moment kyç ky i pavarësisë dhe i historisë kombëtare, si dhe përgatiti kështu terrenin për mbledhjen e Kongresit të Lushnjës, në lidhje dhe marrëveshje me patriotët e mëdhenj, si Kadri Hoxha, Aqif pashë Elbasani, Abdi Toptani, Eshref Frashëri, Myrtesim Këlliçi e të tjerë. Ai e vuri vazhdimisht shtëpinë e tij në shërbim të çështjes së madhe kombëtare. Aty u zhvilluan mbledhje të rëndësishme të përfaqësuesve të popullit të Tiranës e më gjerë.

Në dokumentet historike dhe në dëshmitë e pjesëmarrësve (sipas akademikut Apollon Baçe) faktohet se, bazuar në rrethanat dhe situatën në të cilën ndodhej Shqipëria, Qeveria e Lushnjës vendosi në 9 shkurt 1920, të shpallte Tiranën si kryeqytet të përkohshëm.

Kongresi i Lushnjës e shpalli Tiranën kryeqytet dhe

“...më 11 shkurt 1920, Kabineti i ri i zgjedhur nga Mbledhja Kombëtare filloi nga puna dhe Tirana u shënua për Kryeqytet”.

Arsyet që Tirana u shpall kryeqytet ishin të shumta, si pozita gjeografike e mire, zonë e pasur, me mundësi të mëdha zhvillimi. Kandidaturat e tjera

si Shkodra apo Durrësi, ishin pranë ushtrive pushtuese dhe kufirit, po ashtu dhe qytetet e tjera nuk i kishin mundësitë e Tiranës. Jeta e gjithanshme politike, diplomatike dhe ekonomike, me aktivitet të plotë, si kryeqytet i Shqipërisë filloi më 11 shkurt 1920.

Tirana dhe kryetari i Bashkisë së parë të Tiranës kryeqytet, Ismail efendi Ndroqi, u vu krejtësisht në shërbim të mbledhjes së Kongresit të Lushnjës. U morën të gjitha masat për futjen e qeverisë në Tiranë, në qoftë se ushtria pushtuese italiane do të kundërvepronte. Komanda italiane ishte përgatitur që të mos lejonte hyrjen në Tiranë të qeverisë shqiptare të Kongresit të Lushnjës. Ndërsa Ismail Ndroqi, me përkrahjen e popullsisë së Tiranës, kishte marrë të gjitha masat mbrojtëse në qytet dhe në fshatrat e Tiranës për hyrjen dhe vendosjen e qeverisë në Tiranë.

Se sa delikate ishte pozita dhe gjendja politike asokohe në Tiranë, kuptohet vetvetiu. Nga një anë populli me drejtuesit e tij mezi priste përfundimet e Kongresit të Lushnjës dhe qeverinë e tij, nga ana tjetër, ushtria pushtuese italiane kërcënonte me armë dhe donte të pengonte çdo gjë. Ismail Efendiu, me gjakftohtësinë e tij të rrallë dhe me taktin politik të hollë, diti të dilte nga kjo situatë.

Ai i komunikoi komandantit ushtarak italian vendimet e kongresit dhe të qeverisë së tij, si dhe vullnetin e popullit shqiptar për të mbrojtur me çdo mjet të drejtat e tij. Nga ana tjetër, ai e lajmëroi për pasojat e rënda që do të kishte për ushtrinë italiane, nëse tentohej ndonjë veprim kundër atij vullneti dhe qeverisë që po vinte. Ismail Ndroqi, bashkë me disa luftëtarë të tjerë, pa u trembur aspak, përmes mitralozëve të rreshtuar në anët e rrugës, u nis për në Qafë Kashar, për të pritur qeverinë e re. Ai kishte përdorur gjithmonë fjalën, argumentin dhe bindjen, si edhe me komandantin italian të ushtrisë në Tiranë, por në këtë moment vendimtar, në kundërshtim me parimet e tij, ai kishte marrë nagantin nën pelerinën e kryetarit të bashkisë, për të mbrojtur anëtarët e qeverisë, në rast nevoje. Këto situata, ato javë dhe momentet vendimtare në lidhje me ushtrinë italiane i përshkruan edhe Hoxha Kadria, ministër i Drejtësisë, në letrën drejtuar familjes.²

Tirana ishte shpallur kryeqytet i Shqipërisë dhe Ismail Ndroqi ishte zgjedhur kryetar i parë i Bashkisë së Tiranës kryeqytet. Ai mori të gjitha masat për vendosjen e rregullit dhe zbatimin e vendimeve të qeverisë së re dhe për bashkimin kombëtar, sidomos në këtë periudhë ku fatet e atdheut ishin në rrezik të madh. Dëshmitarët dhe politikanët e kohës i quajtën këto

² Arkivi personal, cituar nga Prof. Nevila Nika në konferencat për 100-vjetorin e Pavarësisë dhe 100-vjetorin e kryeqytetit.

momente të viteve 1919-1920, si pavarësia e dytë e Shqipërisë, “*de jure dhe de facto*”, për të cilat hedhin dritë shumë dokumente të kohës.

Në krye të popullit të Tiranës, ai mbrojti qeverinë nga sulmi që përgatitën mercenarët që vinin nga drejtimet e Krujës. Luftoi fuqimisht kundër veprimeve të disa fuqive të huaja, ishte një nga organizatorët e batalionit vullnetar të Tiranës që mori pjesë në Luftën e Vlorës, të cilët i përcolli deri në afërsi të Shijakut.

Më 22 prill 1920, organizoi një miting me 30.000 vetë, ku si kryetar i Bashkisë të Tiranës protestoi dhe nënshkroi protestën në emër të tyre, dërguar Konferencës së Paqes në San Remo, kundër shpifjeve dhe deklaratave antishqiptare të disa forcave të huaja shoviniste që donin gllabërimin edhe të atyre territoreve shqiptare të copëtuara që kishin mbetur, duke kërkuar nga konferenca, që të mos mohoheshin vendimet e marra nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, 1913.

Në dhjetor të vitit 1920, i dërgoi telegram falënderimi zotit Justin Godart në Paris (kryetar i Dhomës së Deputetëve të Francës), ku shkruhej:

“Pranimi i vendit tonë në Lidhjen e Kombeve, mbush me gëzim zemrat e të gjithë popullsisë së qytetit të Tiranës e rrethinave. Për këtë përfundim fatlum, kanë ndihmuar tepër përpjekjet tuaja të palodhshme. Unë shpreh mirënjohjen tonë të thellë, në emër të popullsisë së Tiranës”.

Ismail Ndroqi, ishte ndër organizatorët e mitingut të përgjithshëm të trevës së Tiranës, më 5 tetor 1921. Gjithashtu, dha një kontribut të madh si anëtar i shoqërisë “Dituria”, si anëtar i këshillit të shoqërisë demokratike “Bashkimi” (1920-1924), dhe si anëtar i partisë popullore “Xhoka”. Në aspektin shoqëror ai ishte faktor bashkimi, harmonie dhe i zbutjes së konflikteve sociale në qytet. Në kryengritjen e Elez Isufit, ai u përpoq dhe shërbeu duke vënë në rrezik jetën e tij si ndërmjetës, për të ndaluar vazhdimin e një gjakderdhjeje të kotë.

Të shumta janë edhe veprimtaritë e tij për zhvillimin e qytetit. Së bashku me inxhinier Eshref Frashërin organizuan planimetrinë, plane rregulluese të përkohshme, planin rregullues të vitit 1921, dhe përgatitën planin e ri rregullues të kryeqytetit, i cili u bë realitet në vitin 1923. Plani i parë ishte hartuar prej austriakëve, më 1916 -1917. Nën drejtimin e tij, Tirana filloi zhvillimin në një stad tjetër. Filloi hapja e rrugëve që ishte një operacion i vështirë, duke hapur akse të drejta e të gjera, si Rruga e Durrësit, që shihte nga larg qendrën e qytetit. U zgjerua rruga “28 Nëntori” dhe rruga e quajtur më vonë “Nana Mbretneshë”, pastaj bulevardi i Rrugës së Kavajës.

U projektuan lulishte publike që filluan të ngrihen. U spostuan varrezat që gjendeshin pranë çdo xhamie dhe që pengonin zhvillimin e qytetit.

“*Kudo shihen përprojekte për organizim e zhvillim*”, - shprehet në ditaret e tij Justin Godart për Tiranën. Një lagje e Tiranës, mbi Selvinë, rreth Kodrës së Kuqe, quhej “Ismail Efendi”, siç shihet edhe në hartat e dokumentet e pasvitit 1920. Ismail Ndroqi u përpoq ta nxirrte Tiranën nga gjendja e rëndë ekonomike dhe shkatërrimet e pësuar nga Lufta e Parë Botërore, zija e bukës dhe gripi spanjoll, që sollën ushtritë e huaja (në banorët e kryeqytetit pati 4000 vdekje).

Ai mori një seri masash për të ngritur disa institucione sociale e kulturore. Ishte ndër organizatorët e ngritjes së Strehës Vorfnoe në 1917-n për fëmijët e mbetur jetimë e ata të rrugëve, për shkak të zisë së bukës dhe shuarjes së familjeve nga gripi spanjoll. Në dhjetor të vitit 1920, ai e organizoi ngritjen e Spitalit Civil të Tiranës (34, 35) me pajisje të mira të siguruara nga Kryqi i Kuq Amerikan, vendosur në qendër të qytetit, pranë Sahatit, që “...*ishte mjaft i përshtatshëm*”, - shkruan Justin Godart, në vitin 1921. Më pas ai shton:

“Qyteti i Tiranës ishte mjaft i rëndësishëm dhe pazari kishte 600 dyqane. U organizuan dhe u hapën shkollat. Shkolla e djemve drejtohej nga Mati Logoreci, mbaruar studimet në Francë, (publicist, gjuhëtar... Kishte dhe një shkollë nate me rreth 200 nxënës, midis të cilëve edhe burra mjaft të moshuar. E njëjta përshtypje të krijohet edhe në shkollën e vajzave. Në shkollën e Kryqit të Kuq Amerikan klasat ishin të përziera. Kishte rreth 250 fëmijë, edhe nga Strehë Vorfnoe, një kompani Boy Scout-ësh, një infermieri dhe një muze të vogël. Miss Williams që drejtonte shkollën, fliste me fjalët më të mira për zgjuarsinë e fëmijëve shqiptarë”.

Ismail Ndroqi, pasi ishte informuar se Kryqi i Kuq Amerikan kërkonte të hapte një shkollë moderne në Shqipëri (është fjala për Shkollën e Mesme Teknike të Fulz-it), i kërkonte me shkrim qeverisë dhe Kryqit të Kuq Amerikan:

“Kishte qenë mirë që Shkëlqesia Juaj të ndërmjetësojë për hapjen e një shkolle tjetër këtu në Tiranë, meqenëse dega e arsimit ka mbetur më prapa në krahasim me qytetet e tjera dhe ka nevoja të mëdha për arsimim”.

Shpejt, kjo nismë u bë realitet dhe kështu, u hap Shkolla Teknike. U bë një ndër organizatorët dhe anëtarët themelues të Kryqit të Kuq

Shqiptar, më 1921. Problemet e simboleve fetare në institucione ishin delikate, prandaj, kur i kërkuan mendim, nëse ka ndonjë pengesë fetare për adoptimin e emblemës “Kryqi i Kuq”, ai u përgjigj:

“Derisa nuk është shenjë dalluese e një feje, por është simbol i një organizate bamirësie internacionale, nuk ka asnjë pengesë nga pikëpamja e fesë sonë”.

Më 10 korrik 1920, u ngrit në Tiranë Biblioteka Kombëtare, drejtuar nga patrioti Sotir Kolea, u siguroa godina, personeli dhe librat (44), ku kontribut të rëndësishëm dha edhe kryebashkiaku Ndroqi. Tirana në ato vite të drejtimit të bashkisë nga Ismail Ndroqi, filloi të ndryshojë pamje, duke u kthyer në një qendër të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore për të gjithë Shqipërinë. Ai kishte një horizont të gjerë kulturor dhe pikëpamje politike për demokraci dhe parlamentarizëm, për respektimin e pikëpamjeve të ndryshme, për debatin si dhe për votën e lirë, kundër diktatit dhe veprimeve të dhunshme.

Ai mbeti ashtu siç e karakterizonte gazeta “Shqipëria e Re” e Kostancës:

*“Njeri i ndershëm, atdhetar i mirë dhe i vërtetë, i zhveshur prej rrobës së fanatizmit. Ai ishte përbetuar ta vinte peng jetën për hir të kombit”.*³

Ai ishte kundër masave të marra më 1922 nga ministri i Brendshëm për ndalimin e mitingjeve, mbledhjeve dhe konferencave e gjyqeve për ndjekjen e kundërshtarëve në Këshillin Kombëtar, kundër ligjit të djegieve e konfiskimeve të pasurive të të dënuarve. Rrethet demokratike të Tiranës, ndër të cilat shquhej veprimtaria e atdhetarit Ismail Ndroqi, iu kundërvunë kësaj rryme, duke ngritur zërin për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, që do të miratonte ligjin themeltar të shtetit, një ndër vendimet e Kongresit të Lushnjës.

Gjatë viteve 1923-1924, Ismail Ndroqi mori pjesë aktivisht në partinë “Xhoka” dhe bashkëpunoi me patriotë të tjerë të Tiranës e më gjerë, si me Hafiz Dalliu, Beqir Lugën, Musa Maçin, Isuf Elezin, haxhi Isuf Bankën, Myhedin Llagamin, në Kavajë me Isuf Kazazin, në Peqin me Adem Gjinishin, si dhe me Kadri Hoxhën, Hasan Prishtinën, Bajram Currin e të tjerë. Ismail Ndroqi vuri kandidaturën në emër të partisë “Xhoka” dhe me gjithë makinacionet e përdorura nga agentë të një krahu politik të qeverisë, Ismaili fitoi shumicën e votave. Më pas, si rrjedhojë e turbullirave dhe ngjarjeve të dhunshme të vitit 1924 dhe konflikteve me

3 Gazeta “Shqipëria e Re” e Kostancës, Rumani, 28 qershor 1921.

armë e vrasjeve, atë e larguan, e mënjanuan, kundër dëshirës së popullit për të cilin luftoi gjithë jetën.

Kur pa se idealet për demokracinë dhe parlamentarizmin po lëkundeshin në atë kohë, edhe ai vetë u tërhoq dhe u mor me misionin e tij fetar. Ishte myfti i Tiranës në vitet 1924-1929, më pas e mënjanojnë në Durrës si myfti të Durrësit, derisa vdiq më 1944.

“Si myfti i Durrësit, Ismail Efendiu, ka lënë gjurmë të paharruara... Ai e filloi dhe mbaroi ndërtimin e Xhamisë së Madhe në qendër të Durrësit, që ishte ndër xhamitë më të bukura të Shqipërisë”,

- shkruan më 1992, personaliteti i kulturës sonë, imam Vehbi Ismaili nga Miçigani (SHBA).

Shtëpia e tij dykatëshe në qendër të Tiranës, në vitet në 1930 u bë ministri, e më pas shkollë e pëzier për djem e vajza, ndër të parat në Tiranë. Me fjalën e mençur, filozofinë, patriotizmin dhe qytetarinë, ai edukonte harmoninë dhe emancipimin. Ai fitoi një respekt të thellë nga bashkëqytetarët edhe në qytetin e Durrësit, për të gjitha veprat e mira që bëri atje. E priti me urrejtje të thellë pushtimin fashist. Kur pa uljen e flamurit kombëtar, nuk i përmbante lotët, duke thënë me dëshpërim:

“... për këtë Flamur luftuam gjithë jetën, por Ai mbetet lart në zemrat tona dhe do të vijë shpejt koha e do të ngrihet përsëri më lart”.

Shtëpia e tij ishte bazë për luftëtarët antifashistë, si Mustafa Gjinishi, Medar Shtylla, Enver Sazani, Myslym Peza, Irfan Celkupa, të njohur në rrethin e Durrësit etj. Gjithashtu, aty mblidheshin ndihma për lëvizjen kundër pushtuesit. Të birin, Dr. Shefqet Ndroqin, nuk e ndali të shkonte në luftë, edhe pse i vihej në rrezik jeta, ndaj i thoshte:

“Vepra si ta gjykosësh bir, cila është e nevojshme për Atdheun. Edhe unë asnjëherë nuk jam kursyer për Atdheun”.

Ismail Ndroqi vdiq më 5 mars 1944 dhe ditën e varrimit të tij banorët e Tiranës dhe të Durrësit, në shenjë respekti e nderimi, mbyllën tregun. Gazeta të ndryshme, si për shembull, “Kultura Islame”, shkruan artikuj për të.

“Vdiq flamuri i nacionalizmës, Ismail Efendi Ndroqi”.

Ndërsa fjalën në ceremoninë e varrimit e mbajti arsimtari i shquar patriot, Ramazan Jarani, i cili mes të tjerash tha:

“Vdiq një dijetar, vdes një botë”.

Patrioti, teologu dhe filozofi largpamës, Hafiz Ali Korça, shkruante atë ditë:

“Shqipëria filloi të humbasë disa nga burrat e mëdhenj e me famë. Tani humbi edhe dijetarin e të ndershmin Ismail Efendi Ndroqin. ... Para popullit asht sjellë aq mire, sa askush prej tij nuk ankohej. Ai jashtë ligjit nuk ka dalë kurrë. Iku e u nda prej gjirit tonë, por nuk e di se vallë, a do ta zërë kush vendin e tij?! Nuk besohet”.

Bibliografia

1. Gazeta “Bashkimi i Kombit”, Tiranë, 12 mars 1944.
2. Hafiz Ibrahim Dalliu “Patriotizma në Tiranë”, Botimi I, 1930 dhe ribotim 1995.
3. Kristo Frashëri “Historiku i Tiranës”, Vëll. I, 2004.
4. Docent Sinan Tafaj: “Figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, revista “Dituria Islame”, organ i Bashkësisë Islame Kosovë, viti V, Nr. 28, gusht 1991. Botuar edhe në librin e Imam Vehbi Ismailit: “Disa fetarë, patriotë, muslimanë shqiptarë”, Botimi I, Michigan, USA, 1991. Revista “Kultura Islame”: “Vdiq flamuri i nacionalizmës – Ismail Efendi Ndroqi”, Viti V, Nr. 7-8, mars-prill, 1944.
5. Lef Nosi “Dokumente historike për t’i shërbye historisë sonë kombëtare”, Elbasan, Vëll. I, Nr.1, mars 1924.
6. Lef Nosi “Dokumente Historike”, 1912-1918, Botimi II, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007.
7. Hafiz Ali Korça, “Shtatë ëndrrat e Shqipërisë”, Shtypshkronja “Mbrothësia”, Tiranë, 1924, ribotim II, Shtypshkronja e Shtetit, 1944, dhe ribotim III, Tiranë, 2006.
8. Hafiz Ali Korça, “I ndjeri Myfti Ismail Efendi Ndroqi” (shkrim me rastin e vdekjes), revista “Kultura Islame”, Viti V, Nr. 7-8, mars-prill 1944.
9. Prof. Sinan Tafaj, “Figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, revista “Dituria Islame”, Prishtinë, Viti II, Nr. 28, gusht 1991.
10. Prof. Sinan Tafaj, “Figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare

- Shqiptarë”, Biblioteka Muslimane Shqiptare, Nr. 31, “Disa fetarë patriotë, muslimanë shqiptarë”, Botim I, 1992, Albanian Islamic Center, Michigan, USA.
11. Revista “Kultura Islame”, “Një jetëshkrim i shkurtër i të ndjerit Ismail Efendi Ndroqi”, viti 1944, Nr. 7-8.
 12. Lef Nosi, “Dokumente Historike”, 1912-1918, Botimi II, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007, “Kongresi i Durrësit” f. 288-301.
 13. Lef Nosi, “Dokumente Historike”, 1912-1918, Botimi II, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007, “Kumanda e lartë e fuqive italiane në Ballkan”; Sekretariati për punët qytetare, f. 282.
 14. Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, “Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirim Kombëtar, 1918-1920”, Vëllimi II, Tiranë, 1976.
 15. Arkivi Qendror i Shtetit, Viti 1919, Dosja 10, f. 251.
 16. “Dokumente Historike”, Arkivi Qendror i Shtetit, Dosja 18, V, 1920, f. 258.
 17. Hafiz Ibrahim Dalliu, “Patriotizma në Tiranë”, Ribotim, 1985.
 18. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi Ministria e Brendshme, Dosja 833, Viti 1921, f. 4.
 19. Justin Godart, “Ditarët Shqiptarë”, mars 1921-dhjetor 1951, Shtëpia botuese “Dituria”, 2008. Arkivi Qendror i Shtetit, Viti 1919, Dosja 28/5, 1922, f. 258.
 20. Igli Gugashi, “Gjeneza e fisit Ndroqi”, Shtëpia botuese “Almera”, Tiranë, 2008.
 21. “Tirana 1604-1937”, botue prej Bashkisë, me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë, Shtypshkronja “Luarasi”, Tiranë, 1937.
 22. Aurel Plasari, referat dhe bisedë në TVSH, “Përvjetori i ngritjes së Bibliotekës Kombëtare”, korrik 2012.
 23. Shefqet Ndroqi, “Një jetë për jetën”, Dritëro, 1998, f. 37.
 24. Ramazan Jarani, “Fjala nekrologjike në varrimin e të ndjerit Ismail Efendi Ndroqi”, Revista “Kultura Islame” Viti V, Nr. 7-8, mars-prill.
 25. Hafiz Ali Korça, “I ndjeri Ismail Efendi Ndroqi”, Revista “Kultura Islame”, Viti V, Nr. 7-8, mars-prill, 1944.